

DRITAN EGRO

**PERCEPTIMI I PERANDORISË OSMANE DHE I EUROPËS
NË DOKTRINËN NACIONALISTE SHQIPTARE**

Nacionalizmi shqiptar është një nga fenomenet ballkanike më interesante të shek. XIX. Dhe kjo për faktin se shqiptarët janë i vetmi popull ballkanik që në shekullin e nacionalizmit nuk e ndjenë nga pas mbështetjen konstante të një fuqie të madhe të kohës. Konvertimi masiv i shqiptarëve në Islam fillimisht u garantoj atyre integrim të plotë në strukturat e Perandorisë Osmane, kurse në shek. XIX dëshmoi se kishte krijuar një realitet që po punonte në disfavor të interesave të tyre kombëtare.

Në këtë artikull, që shtrihet në një trajektore kohore gjatë gjithë shek. XIX, do të përpiqem të hedh dritë mbi faktin se si disa nga zërat më të fuqishëm të nacionalizmit shqiptar e konsideronin Perandorinë Osmane dhe se si ata e shihnin Europën në momentin kur shkruan; madje, edhe se si ata e shihnin të ardhmen e Shqipërisë me këto dy fuqi që dominuan terrenin politik euro-aziatik për shumë shekuj me radhë.

Vrasja e Ali Pashë Tepelenës dhe fillimi i kryengritjes greke për pavarësi u dha të kuptonte krerëve shqiptarë të Shqipërisë Qëndrore dhe Jugore se situata politike në Ballkan tashmë po ndryshonte në mënyrë të pakthyeshme dhe po hidheshin hapa vendimtarë që do të ndryshonin jo vetëm realitetin gjeopolitik të rajonit por edhe fatin e popujve të tij.¹ Në këto momente krerët myslimanë shqiptarë filluan seriozisht të mendojnë për t'u shkëputur nga shteti osman.²

Nga një letër drejtuar krerëve shqiptarë, në nëntor 1828, Ismail bej Vlora (gjyshi i Ismail Qemalit) mësojmë perceptimin e një udhëheqësi

¹ H. Erdem, “ ‘Perfidious Albanians’ and ‘zealous governors’: Ottomans, Albanians and Turks in Greek War of Independence”, *Ottoman Rule and the Balkans, 1760-1850: Conflict, Transformation, Adaptation*, Proceedings of an international conference held in Rethymno, Greece, 13-14 December 2003, eds. A. Anastasopoulos & E. Kolovos, University of Crete, Rethymno 2007, s. 213-37.

² Dritan Egro, “Disa të dhëna të reja mbi fillimet e nacionalizmit shqiptar”, *Studime historike*, nr. 3-4, Tiranë: 2009, s. 5-17.

shqiptar për shtetin osman, në kushtet e reja historike.³ Në këtë dokument shihet qartë se shqiptarët kishin filluar ta vinin në diskutim besnikërinë e tyre ndaj Portës së Lartë; kishin filluar që fatin e tyre ta shihnin të lidhur me vendin e tyre, krejt ndryshe nga ai i perandorisë. Të vetëdijshëm për fuqinë e vet politike e ushtarake ata nuk ngurruan të bënin marrëveshje mes familjeve të tyre⁴ dhe më gjerë në kuvende⁵ për të harmonizuar veprimet politike dhe ushtarake në funksion të shkëputjes së plotë nga shteti osman. Natyrshëm që Shqipëria, si territor, për ta fillonte e mbaronte në kufijtë ku shtriheshin zotërimet e tyre.⁶ Në këtë sfond historik lind *çështja shqiptare*; qysh në vitet '20 të shek. XIX dhe deri në Kongresin e Berlinit (1878) ajo mbeti një çështje e brendshme e perandorisë, pra një marrëdhënie e drejtpërdrejtë mes shqiptarëve dhe Portës së Lartë.⁷

Falë privilegjeve që kishte gëzuar gjatë shekujve të mëparshëm, paria myslimane shqiptare e ndjente veten të fuqishme për të ndërmarrë hapin e shkëputjes, madje nuk e ndjente nevojën për ndihmë nga jashtë.⁸ Kësaj fuqie shqiptare i trembej edhe vetë perandoria, e cila ndërmoi masa ekstreme deri në eliminimin fizik të pjesës më të madhe të elitës shqiptare në Manastir, në gusht të vitit 1830.⁹ Për zhvillimet politike në Greqi ku ishte dora e Fuqive të Mëdha, Ismail bej Vlora shprehet kështu:

³ Arkivi i Kryeministrisë, Stamboll (më tej: BOA), Hatt-ı Hümayun, 21436-B (Arnautvut ileri gelenlerine hitaben Avlonyalı İsmail bey'in mektubu, 29 kasım 1828).

⁴ *Po aty*, Hatt-ı Hümayun, 21436 – A (20 korrik 1828).

⁵ *Po aty*, Hatt-ı Hümayun, 21436-B.

⁶ Për të dhëna shumë interesante që vijnë nga arkivat britanike në lidhje me pushtetin tradicional të familjeve myslimane shqiptare gjatë sundimit osman shih: Irakli Koçollari, *Ali Pasha dhe Shqipëria në arkivat britanike*, "Iceberg" Publishing House, Tiranë: 2013, f. 94-95.

⁷ Dritan Egro, "Ribërja politike e Ballkanit (shek. XVIII- fillimshkulli XX) dhe lëvizja nacionaliste shqiptare", *100 years Albanian Independence*, International Conference held in Tirana, Albania, 26-27 November 2012, Center for Albanian Studies – Institute of History, forthcoming, s. 7-16.

⁸ BOA, Hatt-ı Hümayun, 21436-A (Avlonyalı İsmail bey'e hitap edilen Silahdar İlyas Poda'nın mektubu, 20 korrik 1828).

⁹ Shkëlzen Raça, *Marrëdhëniet shqiptaro-greke, 1829-1881*, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë: 1990, f. 47-8.

“me ndihmën e Zotit të Madh i rregullojmë ne punët e grekëve”,¹⁰ por në komunikimin ndërshqiptar të kësaj kohe Europa ende nuk është shfaqur.

Ndërkohë që paria myslimane shqiptare, e gjendur në pozita drejtuese në strukturat osmane po kërkonte shkëputjen, përfaqësues shqiptarë të konfesionit ortodoks u bënë gjithashtu pjesëmarrës të zhvillimeve të reja politike, si pjesë e zhvillimeve ballkanike që po evoluonin nën udhëheqjen e Ruisë. Naum Veqilharxhi Europën e perceptonte si botën e qytetëruar, si objektivin ku duhet të mbërrijnë të gjithë popujt e sunduar. Për këtë problem, ndonëse nuk i referohet qartësisht Europës, nuk ka asnjë ekuivok se për të Europa ishte toka e kombeve të qytetëruara, ku shprehet ai: “me vullnetin e Perëndisë, shpresojmë të vihemi në rradhën e kombeve të qytetëruara”.¹¹ Për të, Europa më tepër se një hapësirë konkrete gjeografike ishte një standart se ku kishte arritur qytetërimi; me fjalë të tjera, një stacion se ku duhet të mbërrinte treni i popujve të sunduar.¹²

Traktati “E vërteta mbi Shqipërinë dhe shqiptarët”, e hartuar nga Pashko Vassa në vitin 1879,¹³ pra në vitet e Lidhjes së Prizrenit, shënon tentativën e parë, të suksesshme, për të paraqitur një doktrinë historiko-politike të nacionalizmit shqiptar. Një intelektual shqiptar, i konfesionit katolik, i shkolluar në Romë e Venedik,¹⁴ por prej vitesh në shërbim të Perandorisë Osmane, ofron një hartë të saktë të kufijve etnikë të

¹⁰ BOA, Hatt-ı Hümayun, 21436-B (Arnavut ileri gelenlerine hitaben Avlonyalı İsmail bey'in mektubu, 29 kasım 1828).

¹¹ Gj. Shushka, *Veprat e Naum Veqilharxhit*, Prishtinë: Ndërmarrja Botuese RILINDJA, 1994, f. 185.

¹² *Po aty*.

¹³ Kjo vepër në vitin 1879 u botua njëkohësisht në frëngjisht në Stamboll: Wassa Effendi, *Etudes sur l'Albanie et les albanais*, Constantinople: 1879; dhe në Francë: idem., *La vérité sur l'Albanie et les albanais. Etudes historique et critique*, Paris: 1879; në anglisht: idem, *The Truth on Albania and the Albanians. Historical and Critical Issues*, London: 1879; dhe në gjermanisht: idem, *Albanien und die Albanesen. Eine historisch-kritische studie*, Berlin: 1879. Versioni shqip, së bashku me komentet përkatëse, u botua nga Mehdi Frashëri në vitin 1935: Vassa Effendi, *E vërteta mbi Shqipërinë dhe shqiptarët*, Tiranë: Shtypshkronja “Tirana”, 1935. Për më shumë detaje se si ka ndodhur që ky libër u botua njëkohësisht në Stamboll dhe në tre kryeqytete të rëndësishme të diplomacisë evropiane, shih: Kristaq Prifti, “La publication et la diffusion en Europe de l'oeuvre de Pashko Vasa”, *Studia Albanica*, XXXIV, 2001, f. 37-44.

¹⁴ BOA: DH, SAID. 1/236.

territoreve të banuara nga shqiptarët¹⁵ dhe bën thirrje për bashkimin e shqiptarëve të të gjitha besimeve.¹⁶

Duke ndjekur modelin europian të nacionalizmit, ai ofron pikëpamjen e tij mbi *shtetësinë* dhe *racën* në shtetet kombëtare,¹⁷ gjithmonë në funksion të përvijimit të dallimeve etnike mes shqiptarëve dhe fqinjëve të tij.

Pashko Vasa është i pari nationalist shqiptar që fatin e shqiptarëve dhe të kauzës së tyre për ngritjen e një shteti kombëtar, pra çështjen shqiptare e vendos mes Perandorisë Osmane dhe Europës.¹⁸ Në vitin 1879 jo vetëm shqiptarët myslimanë që nuk gëzonin fuqinë e tyre të gjysëm shekulli më parë, por edhe fuqia osmane nuk ishte e tillë sa çështjen shqiptare ta mbante ende në sirtaret e saj. Në se më parë shqiptarët e njihnin diplomatikisht Europën përmes Stambollit, Lidhja e Prizrenit realizoi kontaktet e para të drejtpërdrejta zyrtare mes përfaqësuesve shqiptarë dhe kryeqyteteve europiane.¹⁹

Ndonëse Pashko Vasa vë në dukje dallimet në pozitën e shqiptarëve nën sundimin osman para dhe pas vitit 1831, kohë kur u shembën pashallëqet, ai vë theksin te pozita e padëshiruar në të cilën kishin rënë krerët shqiptarë, sidomos elementi mysliman, falë masave që shteti osman mori për të dobësuar frymën e tyre nacionaliste.²⁰ Përkundrajt këtyre masave që e rënduan sundimin osman në viset shqiptare, Pashko Vasa shprehet:

“Megjithëkëtë Europa që mori pjesë në fakt për të krishterët nuk pati asnjë fjalë mëshire për myslimanët. Kjo është pikëlluese!”²¹

Nga këto fjalë duket qartë se Pashko Vasa Europën e identifikon me Krishtërimin; kështu që, sipas tij, qëndrimi i saj ndaj shqiptarëve shfaqet i paravendosur mbi baza fetare. Dhe pasi thotë këtë, Vasa i kthehet besnikërisë ndaj Perandorisë Osmane duke arritur në përfundimin se

¹⁵ V. Effendi, *E vërteta mbi Shqipninë ...*, f. 26.

¹⁶ *Po aty*, f. 111-112; “Mori Shqipëni, e mjera Shqipëni”, *E vërteta mbi ...*, f. 6.

¹⁷ V. Effendi, *E vërteta mbi Shqipninë ...*, f. 60-61.

¹⁸ *Po aty*, f. 99-100, 101.

¹⁹ Kristaq Prifti, “Misioni i dy shqiptarëve në Evropë (Abdyl Frashërit dhe Mehmet Ali Vrionit)”, *Studime historike*, nr. 3-4, Tiranë: 2006, f. 131-148.

²⁰ V. Effendi, *E vërteta mbi Shqipninë ...*, f. 99-100.

²¹ *Po aty*, f. 101.

shqiptarët e kanë dashur dhe e duan sovranitetin e sulltanit, por ata duan edhe atdheun dhe traditat e veta.²² Ai shkruan:

“Mjafton që qeveria perandorake, ballë së cilës [shqiptarët] janë thellësisht besnikë, t’i zgjasë dorën atërore për ta shkundur nga mefshtësia, ta ngrejë, ta ndihmojë të ecë në udhën e përparimit dhe të qytetërimit dhe atëherë do të marrë rrugën e mbarë”.²³

Duke filluar me Pashko Vasën, nacionalistët shqiptarë fillojnë që fatin e tyre, madje edhe të ardhmen e tyre ta shohin të lidhur ngushtë me atë të shtetit osman. Për këtë ai shkruan:

“... eksperiencia e pesë shekujve e ka provuar se bashkimi i tyre i ngushtë me Perandorinë Osmane formon shansin e vetëm të shpëtimit; ... dhe nuk kërcënon ekzistencën e tij nga pikëpamja e racës dhe e kombësisë”.²⁴

E thënë ndryshe, Pashko Vassa kërkon nga shteti osman njohjen zyrtare të kombit shqiptar, dhe një organizim autonom brenda suazës së tij.²⁵

Duke pasur parasysh se Pashko Vassa këtë libërth fundamental të nacionalizmit shqiptar e shkroi kur sapo kishte përfunduar lufta ruso-osmane e vitit 1878, atashimin e shqiptarëve me osmanët e konsideron si “një element fuqie, një garanci për rend, por edhe një kompesim për territoret e humbura nga kjo luftë”.²⁶

Në këtë vepër hidhet për herë të parë kjo ide, e cila nacionalizmin shqiptar e shoqëroi deri në momentin e shpalljes së pavarësisë nga shteti osman, në nëntor 1912, sipas së cilës shqiptarët duhet të ruajnë autonominë brenda suazës së Perandorisë Osmane, pasi nuk kishte garanci që Europa e krishterë nuk do të ndihmonte shtetet fqinje ballkanike në kurriz të ekzistencës së një shteti me popullsi shumicë myslimane në Europën Juglindore.

²² *Po aty*, f. 99.

²³ *Po aty*, f. 102.

²⁴ *Po aty*, f. 110.

²⁵ *Po aty*, f. 119-120.

²⁶ *Po aty*, f. 112.

Në traktatin e tij politik *Shqipëria ç'ka qenë, ç'është e ç'do të bëhet*,²⁷ të shkruar 20 vjet më pas, Sami Frashëri gjen rastin të avancojë mendimin nacionalist shqiptar, në përputhje me zhvillimet që kishin ndodhur brenda këtij segmenti kohor në arenën ndërkombëtare e veçanërisht në Ballkan.

Te tërheq vëmendjen fakti që S. Frashëri qëndrimin e tij ndaj fqinjëve dhe politikave të tyre i vendos në sythin e titulluar *rreziqet për Shqipërinë*²⁸ duke e shprehur qartë frikën që tashmë shqiptarët kishin prej tyre. Brenda një shekulli shqiptarët nga administratorët faktikë të Ballkanit ishin shndërruar në plaçkën e tregut me të cilën duheshin nginjur fqinjët, të cilët në terren realizonin ekuilibrin e fuqisë mes Fuqive të Mëdha.²⁹ Shtetin osman S. Frashëri e konsideron mes fqinjëve të Shqipërisë, të cilët i konsideron të rrezikshëm për të ardhmen e vendit. Me politikën e saj për të ruajtur me fanatizëm kontrollin mbi shqiptarët shteti osman, në një farë mënyre, kishte bashkuar armët me fqinjët grekë e serbë.³⁰ Nën presionin europian shteti osman gjithnjë e më tepër nuk po i kontrollonte territoret e krishtera të Ballkanit, ndërkohë që ndaj shqiptarëve mbante qëndrimin më të ashpër të mundshëm që gjuha shqipe të mos futej në shkolla.³¹

Nga ana tjetër, fuqitë europiano-perëndimore dhe Rusinë S. Frashëri i klasifikon në sythin *miqtë e shqiptarëve*,³² ndaj i kërkon Europës ta njohë zyrtarisht ekzistencën e Shqipërisë.³³ Duke i trajtuar në këtë mënyrë Sami Frashëri e redukton përgjegjësinë për rrezikun e ekzistencës së Shqipërisë së pavarur tek fqinjët me interesa të drejtpërdrejta territoriale, ndërkohë që, në mënyrë diplomatike, të gjitha Fuqitë e Mëdha, për vetë peshën që kishin në procesin e ribërjes politike të Ballkanit, i konsideron si mike të shqiptarëve. Megjithatë, S. Frashëri është tepër i kujdesshëm në përkufizimin e çdo fuqie të madhe dhe manifeston një njohje brilante të

²⁷ Sami Frashëri, *Shqipëria, ç'ka qenë, ç'është e ç'do të bëhetë (Mendime për shpëtimt të mëmëdheut nga reziket që e kanë rethuarë)*, Bukuresht: 1899.

²⁸ Sami Frashëri, *Shqipëria, ç'ka qenë, ç'është e ç'do të bëhetë (Mendime për shpëtimt të mëmëdheut nga reziket që e kanë rethuarë)*, Prishtinë: RILINDJA, 1978, f. 55-59.

²⁹ D. Egro, "Ribërja politike e Ballkanit ...", s. 7-16.

³⁰ S. Frashëri, *Shqipëria, ç'ka qenë ...*, Prishtinë: 1978, f. 55-56.

³¹ *Po aty*, f. 59.

³² *Po aty*, f. 59-62.

³³ *Po aty*, f. 80.

interesave të tyre madhore dhe lokale, por gjithsesi duke i rreshtuar ato vetëdijshëm në sythin e *miqve të Shqipërisë*.

Franca përshkruhet si një mike e vjetër e shqiptarëve, por Sami Frashëri nuk lë pa vënë në dukje dashurinë e saj të veçantë për katolikët e Mirditës.³⁴ Italia ka brenda saj komunitetin arbëresh, që është përpjekur shumë për bashkimin e shtetit italian; ky shtet, sipas tij, në asnjë mënyrë nuk do të lejojë që Greqia dhe Serbia ta copëtojnë vendin amë të arbëreshëve.³⁵ Perandoria Austro-hungareze, është mike e Shqipërisë, ndaj, sipas S. Frashërit, ajo kurrsesi nuk do të lejonte shtrirjen dhe rritjen e pakontrolluar të sllavëve në Ballkan; dhe për këtë gjë, thotë ai, ajo do t'i përkrahë fort shqiptarët, ashtu siç po bën edhe për rumunët.³⁶

Qëndrim shumë interesant Sami Frashëri mban ndaj Rusisë, të cilën e konsideron si mbështetësen kryesore të shteteve sllave ballkanike, për shkak të origjinës së njëjtë të racës, por këtë fuqi të madhe të kohës ai e konsideron si një shprehëse të fjalës së mirë dhe ndihmëse të shqiptarëve; veçse, ai nuk harron të vërë në dukje se Rusia në emër të ortodoksisë ka mbështetur gjithnjë edhe Greqinë, ndonëse, sipas tij grekët ushqejnë ndjenja armiqsore ndaj sllavëve të Ballkanit.³⁷

Më tej ai vijon duke thënë se deri në atë kohë shqiptarët nuk kishin gjetur një mik të madh që t'i mbështeste fuqishëm në ndërtimin e shtetit të tyre kombëtar; dhe këtu si arsye kryesore të kësaj mungese me pasoja fatale ai paraqit diversitetin fetar të shqiptarëve.³⁸ Vetëm veprimet e tyre të matura, shprehet ai, do t'i tregojnë të mëdhenjve të politikës botërore se shqiptarët e meritojnë të kenë shtetin e tyre, dhe për pasojë do të fitojnë edhe mbështetjen e tyre.³⁹

Sami Frashëri është në dijeni të projekteve të mëdha politike të kohës, të cilat synonin dëbimin e shtetit osman nga Ballkani dhe ribërjen politike të këtij rajoni. Në këtë kontekst, ai mban një qëndrim shumë të ashpër ndaj shtetit osman, të cilin e akuzon se po mbante të lidhura duart e shqiptarëve, ndërkohë që fqinjët po realizonin një nga një objektivat e tyre strategjike.⁴⁰ Madje, në dritën e ligjërimit politik dhe projekteve

³⁴ *Po aty*, f. 60.

³⁵ *Po aty*.

³⁶ *Po aty*.

³⁷ *Po aty*.

³⁸ *Po aty*, f. 60-61.

³⁹ *Po aty*, f. 61.

⁴⁰ *Po aty*, f. 74.

europiane të kohës për dëbimin e osmanëve nga territoret europiane,⁴¹ turqit osmanë ai i identifikon si:

“një komb i egër i ardhur nga shkretëtirat e Azisë së Veriut me nga një hosten në dorë ... Turqit s’kanë të drejtë të rrojnë më tepër se ata shokët e tyre, rrojtjen e qëndrimin deri tani e kanë patur qelepër; tani s’kanë ndonjë të drejtë të rrojnë e të qëndrojnë më, edhe nuk dinë dhe as duan të rrojnë më, se deri më sot s’kanë bërë një kombëri e një qeveri si gjithë bota. ... ”.⁴²

Në këtë kontekst, Sami Frashëri i drejtohet Europës, duke i evidentuar shqiptarët si të ndryshëm nga turqit dhe i përkufizon si : “m’i vjetri komp i Evropësë”, ndaj prej këtui, thotë ai, lind e drejta legjitime “kemi të drejtë në dhet’ t’Evropësë më teprë se çdo komp”.⁴³

Megjithatë, kur vjen fjala për të ardhmen e Shqipërisë, S. Frashëri beson se shqiptarët duhet të qëndronin nën shtetin osman sa të forconin pozitën e tyre shtetformuese; në momentin që shteti osman do të binte në Ballkan, shqiptarët duhet të dilnin më vete.⁴⁴

Ndërsa pranon që Europa e atëhershme ishte vendi i diturisë dhe i qytetërimit të avancuar,⁴⁵ nga ana tjetër, S. Frashëri u drejtohet shqiptarëve të jenë të vëmendshëm ndaj procesit kolonial që po ndodhte dhe, pasi u thotë se vendi i shqiptarëve është Europa, i porosit të mos bëhen koloni e saj:

“Të mos na gjejnë si ata t’egërtit’ e Avstralis’ e t’Afrikësë, që ven’ Evropjanët’ e i gënjejnë me ca ruaza e me ca dragole të qelbërta ... e u marrin vendet’ e tyre nga dora. Të mos gënjehemi edhe na nga disa copa pafillesh e qelqesh që s’vlejnë fare gjë, e të lëmë të drejtat’ e kombit e të mëmëdheut tënë në duar të të huajet e t’armikëve tanë”.⁴⁶

Gjithsesi, pozita e shqiptarëve në Ballkan vjen e rëndohet edhe më shumë në dekadën e parë të shekullit XX. Tashmë në rendin e ditës ishte

⁴¹ Trandafir G. Djuvara, *Cent projets de partage de la Turquie (1281-1913)*, Librairie Félix Alcan, Paris: 1914.

⁴² S. Frashëri, *Shqipëria, ç’ka qenë ...*, Prishtinë: 1978, f. 74.

⁴³ *Po aty*, f. 75.

⁴⁴ *Po aty*, f. 80-81.

⁴⁵ *Po aty*, f. 92.

⁴⁶ *Po aty*, f. 107.

çështja në se do të kishte një atdhe për shqiptarët. Lufta ballkanike që sapo kishte filluar në terren po e rrezikonte realisht projektin për krijimin e një shteti të pavarur shqiptar. Vetëm disa javë para aktit të shpalljes së pavarësisë së Shqipërisë Ismail Qemali i deklaroi shtypit të huaj:

“Përkundër të gjitha iluzioneve edhe unë besoj se Perandoria Osmane i ka humbur të gjitha provincat europiane. ... [Besoj se] e kuptoni që unë e shikoj jo pa keqardhje këtë shkatërrim të sundimit turk në Europë. ... Në se rajonet e pushtuara do të duhet të shkëputen krejt nga Turqia, po ashtu duhet që edhe Shqipëria të bëhet e pavarur. ...”⁴⁷

Këto fjalë të thëna nga Ismail Qemali, udhëheqësi i gjithëpranuar i shqiptarëve të asaj kohe, veçse pohon faktin se ishte krijuar ajo konjunkturë politike ndërkombëtare në Ballkan për të cilën ishte shprehur S. Frashëri në traktatin e tij. Me këto fjalë Ismail Qemali veçse po përmbushte në terren atë çka mendimi nationalist shqiptar e kishte parashikuar në letër. Por i vetëdijshëm për vetminë në të cilën ndodheshin shqiptarët, Ismail Qemali shprehet:

“Në qoftë se shqiptarëve nuk do t’u mjaftojnë forcat për të smbrapsur sulmin e padrejtë [të serbëve, malazezëve apo të shteteve të tjera ballkanike], çka bie ndesh me parimet mbi të cilat shtetet ballkanike bazojnë pretendimet e tyre, atëherë ata nuk do ta humbin shpresën se kombet e qytetëruara të Europës dhe sidomos Fuqitë e Mëdha, të cilat për shkak të pozitës gjeografike dhe të së drejtës së tyre historike janë të interesuara për ruajtjen e rendit në Ballkan, do ta njohin drejtësinë e synimeve tona. Mirëpo, në se shqiptarët trajtohen në mënyrë të padrejtë, kjo i bën ata të vendosur për të luftuar me çdo kusht për të drejtat e tyre. Edhe në se diplomacia nuk do t’i njohë menjëherë të drejtat e shqiptarëve, koha do t’i njohë ato patjetër më vonë”⁴⁸.

Tashmë që sundimi osman në Ballkan kishte vdekur, e ardhmja e shqiptarëve varej sa prej lëvizjeve të tyre diplomatike e ushtarake, aq edhe nga qëndrimi që do të mbanin Fuqitë e Mëdha. Vështruar nga Europa, shqiptarët, një popull me dominancë fetare islame, nuk arritën të

⁴⁷ Ilir Ikononi, *Pavarësia: udhëtimi i paharruar i Ismail Qemalit*, Tiranë: UET Press, 2012, f. 255-256.

⁴⁸ *Po aty*, f. 259.

gjenin një aleat të fuqishëm europian, dhe kjo thjesht për faktin se ata u konvertuan masivisht në Islam; për pasojë, të lidhur ngushtë me sunduesin osman, shqiptarët u konsideruan si mbetje e turqve osmanë në Ballkan⁴⁹ dhe u mbështetën vetëm në momentin kur zgjerimi sllav po mbushte vakuumin e krijuar nga fundi i sundimit osman dhe po lëkundte fort ndikimin tradicional austro-hungarez në rajon.⁵⁰

S u m m a r y

PERCEPTION OF THE OTTOMAN EMPIRE AND EUROPE IN ALBANIAN NATIONALISTIC DOCTRINE

During the XIX century, the era of nationalism, Albanians were the only people in the region who did not feel the constant support of a great power. The massive conversion to Islam, which at the beginning, guaranteed them their full integration into the Ottoman state structure, in the XIX century, proved to constitute a reality that run against their national interests.

Pashko Vassa and Sami Frashëri were the personalities who laid the foundations of the Albanian nationalist doctrine. Meanwhile, Ismail Kemal Vlora, on the 28th of November 1912, put into practice what Pashko Vassa and Sami Frashëri had already anticipated. He proclaimed the independence of Albania, precisely, at the very time of the collapse of the Ottoman rule in the Balkans.

⁴⁹ F. R. Bridge, "Habsburg Monarşisi ve Osmanlı İmparatorluğu, 1900-1918", *Osmanlı İmparatorluğu'nun Sonu ve Büyük Güçler*, ed. Marian Kent, Tarih Vakfı Yurt Yayınları, İstanbul: 1999, f. 46.

⁵⁰ Po aty, f. 47.